



01/Nr. 297 /2025  
Data : 13.01.2025

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dymbëdhjetë -XII- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 19.12.2024 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë , Rini dhe Sport), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Bajrush Laçi** (Udhëheqës i Zyrës Ligjore), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025.
3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.
5. Draft rregullorja komunale për menaxhimin të pasurisë jo financiare komuna Hani i Elezit.
6. Raporti mbi planin e integritetit për vitin 2024.
7. Propozim vendim për hapjen e debatit publik për draft planin zhvillimorë të Komunës së Hanit të Elezit.
8. Propozim vendim për ndërtesat e vjetra kolektive të cilat janë në zonën urbane.
9. Propozim vendim për listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2025 të cilat parashihen të jepen për shfrytëzim.
10. Rishqyrtimi i aktit normativ rregullorja për taksa komunale për vitin 2025.
11. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.Endrit Curri për ndërrim-destinimin e pronës.
12. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.Faton Curri për ndërrim-destinimin e pronës.
13. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi
14. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- kërkoj që pika e shtatë e rendit të punës; propozim vendim për hapjen e debatit publik për draft planin zhvillimorë të Komunës së Hanit të Elezit, të hiqet nga rendi i punës për shkak se ende nuk e kemi marr pëlqimin prej Ministrisë.

**Kryesuesi** thekson:- përveç pikës së shtatë të rendit të punës propozim vendim për hapjen e debatit publik për draft planin zhvillimorë të Komunës së Hanit të Elezit të rendit të punës të cilën kërkoj drejtoria përgjegjëse që të hiqet nga rendi i punës, a keni ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**Procedojmë me këtë rend të punës:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025.
3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.
5. Draft rregullorja komunale për menaxhimin të pasurisë jo financiare komuna Hani i Elezit.
6. Raporti mbi planin e integritetit për vitin 2024.
7. Propozim vendim për ndërtesat e vjetra kolektive të cilat janë në zonën urbane.
8. Propozim vendim për listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2025 të cilat parashihen të jepen për shfrytëzim.
9. Rishqyrtimi i aktit normativ rregullorja për taksa komunale për vitin 2025.
10. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.Endrit Curri për ndërrim-destinimin e pronës.
11. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.Faton Curri për ndërrim-destinimin e pronës.
12. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi
13. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevdi Dernjani** thekson:- është plan i harmonizuar me të gjitha dëgjimet buxhetore të cilat janë mbajtur në vitin 2024 për vitin 2025. Ndër prioritet e planit të punës së kryetarit janë shërbimet ndaj qytetarëve, ngritja e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, rregullimi i infrastrukturës dhe urbanizmi, arsimit familja, zhvillimi ekonomik. Janë shtatëmbëdhjetë objektiva në planin e Kryetarit për vitin 2025. Përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevdi Dernjani** thekson:- është gati se i njëjti për shkak se të gjitha sugjerimet të cilat epen janë edhe për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **5. Draft rregullorja komunale për menaxhimin të pasurisë jo financiare komuna Hani i Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- kjo draft rregullore ka të bëjë me menaxhimin e inventarizimit, vlerësimin e pasurisë Komunale . Është rekomandim i auditorit të brendshëm që komuna me pasur një rregullore të tillë. Nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

**Hyriete Isufi** thekson:- kjo draft rregullore a ka të bëjë me të gjitha pasurit e komunës.

**Natyra Kalisi** thekson:- sipas nenit dy të kësaj rregullore pasurit ndahen në pasuri kapitale si dhe stoqet dhe na duhet me i evidentuar pasurit mbi njëmijë euro, nën njëmijë euro dhe ato të cilat gjenden në depo. Deri tash kemi funksionuar me rregulloren e ministrisë mirëpo tash duhet ta bëjmë edhe rregulloren për shkak të rekomandimit që e ka dhënë auditori.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU DRAFT RREGULLORJA KOMUNALE PËR MENAXHIMIN TË PASURISË JOFINACIARE KOMUNA HANI I ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **6. Raporti mbi planin e integritetit për vitin 2024.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- është obligim ligjorë që duhet të raportojmë në kuvend për planin e integritetit. I kemi mbledhur disa pika të cilat i kemi implementuar gjatë vitit 2024. Përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU RAPORTI MBI PLANIN E INTEGRITETIT PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 7. Propozim vendim për ndërtesat e vjetra kolektive të cilat janë në zonën urbane.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:-bëhet fjalë për ndërtesat e vjetra të cilat janë të ndërtuara në vitet e pesëdhjeta dhe përmes këtij propozim vendimi i propozohet kuvendit që të ju mundësohet pronarëve të këtyre banesave që këto vetë në marrëveshje me investitorët munden me bërë ndërtime të reja në këto parcela pa kompensim ndaj komunës në emër të shfrytëzimit të tokës. Toka ku janë këto banesa e kanë në shfrytëzim të përhershëm. Ndërtimet eventuale duhet të bëhen në pajtim me ligjin e ndërtimit, në bazë të planeve rregulluese urbane.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- për këto ndërtesa edhe më herët kam kërkuar që komuna të ndanë mjete financiare për renovimin e tyre.

**Nexhmedin Daci** thekson:- renovimi është e drejtë e tyre por janë ndërtime të vjetra dhe përmes këtij propozim vendimi të ju mundësohet pronarëve të njësive banesore që me ndonjë investitorë me bërë ndërtime të reja në pajtim me ligjin e ndërtimit dhe në bazë të planit rregullues. Tri prej këtyre ndërtesave kanë angazhuar kompani të cilët e kanë bërë vlerësimin e qëndrueshmërisë të cilën e keni në material që ka konstatuar se banesat nuk janë në gjendje të mirë. Problemi është te parcela që evidentohet si pronë e kuvendit të komunës a në fakt realisht nuk janë. Janë dy ligje që njëri ka kaluar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës. Pronarët e këtyre parcelave kanë me qenë pronarë të këtyre njësive banesore sepse askund në botë nuk ka që shtëpia me qenë e jotja kurse shtëpia e jemja. Prej drejtës romake shtëpia dhe prona janë një send juridik nuk janë dy sende. Statusin momentalë këto e kanë në shfrytëzim të përhershëm por viteve të nëntëdhjeta i kanë privatizuar banesat dhe tash banesat janë private.

**Nora Xhoni** thekson:- nëse ligji nuk është miratuar ende më mirë do të ishte që ligji të përfundon atje dhe pastaj na me vendosur këtu për shkak se mundet me u kthyer në rishqyrtim.

**Nexhmedin Daci** thekson:- nëse kthehet nga MAPL-ja për rishqyrtim si komunë e kemi dhe kush do që ka interesim ne mund të ja tregojmë përgjigjen prej MAPL-së. Sa i përket ligjit në vitin 2019 na është dërguar drafti dhe tash jemi në vitin 2024 dhe ende nuk ka kaluar por gjykatat e njohin Ligjin e tokës ndërtimore të Krahinës së Kosovës me të cilin ju ipet përparësi pronarëve të banesave të vjetra.

**Sevdi Dernjani** thekson:- parimisht pajtohem me drejtorin që duhemi me lejuar dhe me vazhduar si proces, por pasi është zyrtari ligjorë është mirë me dhënë një interpretim rreth kësaj çështje.

**Bajrush Laçi** thekson:- me këtë çështje jemi marr edhe në vitin 2022 por me sa e di unë kjo është kthyer por unë jam që të kalon kështu por një kohësishtë me kërkuar një përgjigje paraprake te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për shkak se ligji najë lejon se me të vërtet është pak pësjtjellët sepse ndërtesat janë të vjetra dhe ligji nuk ka kaluar atje ende.

**Nexhmedin Daci** thekson:- në Ministri kemi qenë me Kryetarin dhe kemi biseduar me drejtorin dhe ato janë në dioni për këtë çështje dhe e kanë të çartë këtë çështje.

**Kryesuesi** thekson:- është pikë e ndishme dhe besoj që të gjithë janë pro për me u vazhduar kjo procedurë dhe me u sqaruar një herë e mirë dhe më intereson që të jetë në rregull me ligjin dhe besoj që ti e ke paraparë dhe jemi për me shtyer më tutje këtë pikë atëherë mbetet se çka thotë MAPL-ja. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR NDËRTESTAT E VJETRA KOLEKTIVE TË CILAT JANË NË ZONËN URBANE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**8. Propozim vendim për listën e veçantë të pronave të paluajshme të komunës për vitin 2025 të cilat parashihen të jepen për shfrytëzim.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- kemi propozuar pesë parcela për me i dhënë me qira në vitin e ardhshëm, dy janë në Pustenik, një në fshatin Krivenik dhe dy në fshatin Rezhancë . Nëse ju kujtohet edhe në vitin 2022 e kemi pasur një lloj të tillë të këtij vendimit . Në performancë të komunës e kemi një pikë që vazhdimisht kërkohet që a e ka komuna listën e parcelave që planifikon me dhënë me qira.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR LISTËN E VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR VITIN 2025 TË CILAT PARASHIHEN TË JEPEN PËR SHFRYTËZIM QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**9. Rishqyrtimi i aktit normativ rregullorja për taksa komunale për vitin 2025.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- te neni 14 ka dhënë vërejtje edhe pse shumë e qartë ka qenë, por ata kanë potencuar se nuk i keni përcaktuar tarifat për lejet mjedisore dhe vetëm i kam përsëritur

**Bajrush Laçi** thekson:- ne kur kemi komunikuar me Ministri kanë potencuar që gabimi është te na por pasi që për shkak të performancës së komunës duhet të rishqyrtohet në Kuvendin e Komunës sepse nëse mbetet vetëm me shkresë munden në vitin e ardhshëm me potencuar që nuk e kemi rishqyrtuar, për ndryshe edhe dy vendimet e tjera të cila i kemi janë të natyrës së tillë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU RYSHQYRTIMI I AKTIT NORMATIV RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**10. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.Endrit Curri për ndërrim-destinimin e pronës.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Abduraman Bushi** thekson:- propozim vendim për me përcjell për kuvend për miratim e kam bazuar në dy arsye. Arsye parë është se sipas planin zhvillimorë komunal zona ku është kjo parcelë është zonë ndërtimore . Arsye dytë është që edhe në fletë poseduese shënon tokë ndërtimore dhe bujqësore. Kërkoj që të përcillet për Kuvend për shkak se qëndrojë pranë vendimit të njëjtë dhe ky vendim është i ligjshëm.

**Bajrush Laçi** thekson:- për zonën e katërt dhe të pestë kuvendi i komunës merr vendim, deri te zona e tretë e jep ministria ndërsa për zonën e gjashtë dhe shtatë shkon përmes drejtorisë. Klasa e pronës ka qenë e klasit të pestë dhe është dashur përmes kuvendit dhe paraprakisht është shikuar është ndërtimore por destinimi ka dashur me ju bërë ndërtimore për shkak se në fletë poseduese ka qenë bujqësore. Përgjigja kur është kthyer nga MAPL-ja kanë potencuar për shkak se na nuk e kemi të paraparë për pjesë të ndërtimit a faktikisht e keni parë ku është zona e ka plotë ndërtesa dhe këto ku janë të ndërtuar janë brenda zonës ndërtimore por ndoshta vijën nuk kanë mundur me parë që është shtuar pak më vonë te PZHK-ja dhe vija ku është bërë ndërtimi është brenda zonës ndërtimore. Na është potencuar që me përcjellë për rishqyrtim në kuvend dhe i njëjti vendim ka me qenë në fuqi.

**U VOTU RYSHQYRTIMI I AKTIT PËR ENDRIT CURRI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **11. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.Faton Curri për ndërrim-destinimin e pronës.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Abduraman Bushi** thekson:-është e njëjta çështje edhe te kjo pikë, diçka të veçantë për me shtuar nuk kam.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU RYSHQYRTIMI I AKTIT PËR FATON CURRI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **12. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Abduraman Bushi** thekson:- komuna ka subvencionuar tridhjetë e tetë fermer bletarë me material ushqyes për bletë pogaçe dhe njëmbëdhjetë fermerë me mekanizëm bujqësorë. Përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- a keni pasur vonesa sa i përket ndarjes së subvencioneve. Bëhet fjalë për 13 fermerë për mekanizëm bujqësorë po në shkresë shënon njëmbëdhjetë fermerë, kërkoj sqarim sa i përket kësaj çështje.

**Abduraman Bushi** thekson:- për me u shpërndare kanë qenë 13 pajisje bujqësore por i kemi pasur 11 aplikuesë dhe dy pajisje tjera ju janë shpërndarë aplikuesve që kanë aplikuar për më shumë se një pajisje.

**U VOTU INFORMATATA PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË BUJQËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### 13. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Arbenita Bajramaliu** thekson:- është vullnet i Kryetarit të Komunës që salla te Shtëpia e Kulturës gjatë periudhës deri sa të përfundojnë zgjedhjet me u liruar pa pagesë . Ju mbetet juve si përfaqësues të subjekteve politike që të dakordoheni.

**Hyriete Isufi** thekson:- si propozim nuk është i keq por duhet partitë politike të merren veshë për oraret.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:58.

**Procesmbajtësi**

**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**

